



Drejtoria për Arsim
Gjimnazi "Ulpiana" Lipjan
SHMP "Adem Gllavica" Lipjan
SHML "Shaqir Hoxha" Shalë
Nr.4-473
Datë: 08.10.2025

FTESË PËR OFERTË

Bazuar në nenin 11 (njëmbëdhjetë) të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 02/2016, ftojme të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertat e tyre për ekskursioni 4 (katër) ditor në Republikën e Shqipërisë për nxënësit maturan të gjimnazit "Ulpiana" në Lipjan, SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan dhe SHML "Shaqir Hoxha" Shalë duke përfshirë shpenzimet e transportit, akomodimin, ushqimin dhe vizitat e përcaktuara sipas kriterëve të Këshillave Drejtues të Shkollave përkatëse.

Agjencionet turistike që konkurrojnë duhet t'i plotësojnë këto kriterë:

- Të jenë të licencuara sipas ligjit mbi transportin e lirë ndërkombëtarë (Ligji 04/L-179, neni 28 dhe UA 11/2013 i MI-së), ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë.
- Të kenë numër të mjaftueshëm të autobusëve, të jenë komfor dhe me klimë.
- Të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe psikik për ngasësit e autobusëve.
- Të ketë dëshmi për kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore.
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit në ekskursion gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës së mjekut dhe kopja e kontratës për përkujdesje gjatë ekskursionit katër ditor.
- Agjencioni duhet t'i paguaj shpenzimet e gjitha vizitave të monumenteve kulturo-historike që janë me pagesë sipas itinerarit të paraparë.
- Ekskursioni organizohet me rreth 400 nxënës për gjimnazin "Ulpiana", 220 nxënës për SHMP "Adem Gllavica" dhe 28 nxënës për SHML "Mikse" Shalë.
- Agjencioni duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret e përcaktuara nga KDSH i shkollave përkatëse.
- Agjencioni duhet të ketë kontratë me hotelin në të cilin do të bëhet akomodimi (Kontrata duhet të ketë datat e akomodimit).
- Agjencioni duhet të ketë konfirmimin e rezervimit nga hoteli në origjinal.
- Agjencioni duhet të ketë licencën e akreditimeve për mallrat ushqimore në vendqëndrimin e nxënësve

Vërejtje:

- Itinerari, orari i nisjes dhe kushtet tjera të akomodimit, merren në zyrat e DKA-së në Lipjan.
- Afati i konkurrimit 7 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës ose shtypin ditor.
- Dokumentet jo komplete nuk shqyrtohen.
- Ofertat hapen pas skadimit të afatit 7 ditor nga dita e publikimit (Oferta do të jetë e hapur nga data 08.10.2025 deri me 14.10.2025 në ora 15⁰⁰)

Drejtori i shkollës: Semir Gashi

Drejtori i shkollës: Skener Rudari

Drejtori i shkollës: Ali Shamolli

